



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

**THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI
PËR KANDIDATËT PËR ANËTARË NË BORDET E ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES I MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, Ministria e Arsimit me qëllim ripërtëritjen e përbërjes së bordeve të administrimit për anëtarët, përfaqësues të saj, për të siguruar planifikimin dhe menaxhimin e fondeve publike në institucionet e arsimit të lartë, shpall thirrjen për kandidatët e interesuar për anëtar, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në bordet e administrimit, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1.	Universiteti Politeknik i Tiranës	• 2 anëtarë përfaqësues i MAS
2.	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	• 2 anëtarë përfaqësues i MAS

1. Bordi i Administrimit funksionet dhe kompetencat

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë.

Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

2. Kërkesat që duhet të plotësojnë kandidatët e interesuar:

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike.
- Të ketë integritet etik dhe profesional.
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.
- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati

- Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë
- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi.
- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

3. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimi

- i. Kërkesë për shprehje interesi, nga cdo kandidat;
- ii. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);
- iii. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës /Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;
- iv. Fotokopje të librezës së punës;
- v. Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- vi. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- vii. Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
- viii. Formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;
- ix. Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;
- x. Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;
- xi. Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;
- xii. Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

4. Kërkesa për shprehje interesi nga çdo kandidat shoqëruar me dokumentacionin e cituar në pikën 3, duhet të depozitohen deri në datën 09.02. 2026, në Ministrinë e Arsimit, në një nga këto mënyra:

- a) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit;
- b) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit.

Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët administrohet nga Ministria e Arsimit i kalon për shqyrtim komisionit “*Ad hoc*” të ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

3. Shqyrtimi i dokumentacionit

- Shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga kandidatët që kanë shprehur interesin për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision “*Ad-hoc*” i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, e cila shpallet në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit: www.arsimi.gov.al.

4. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionin publik të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionin publik të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionin publik të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____